

AKT THEMELIMI

I

SHOQËRISË TREGTARE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

“ OMD - OFFICINA MECCANICA ” SHPK

Ortakët themelues si më poshtë:

- **Z. Filippo Varini**, shtetas Italian, i datëlindjes 23/06/1993, lindur në Borgomanero (NO), ITALI, banues në ITALI, Invario, Rruga Cesare Battisti n. 114, Sub. A, madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtës i kartës së identitetit me Nr.AT 7011904.
- **Z. Erion Topciu**, shtetas shqiptar, i datëlindjes 13/09/1996, lindur në Durres, Shqiperi, banues në Shqiperi, Durres, Rruga Filonid Durrsaku, Nd. 3, H.1, madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtës i kartës së identitetit me Nr.032877690 dhe numer personal J60913071D.

Pjesa e përgjithshme

Bazuar në Ligjin Nr. 9901, datë 14.04.2008, “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, Ligjin Nr. 9723 datë 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Biznesit”, sot me datë 16/01/2023 hartojnë këtë Akt – Themelimi si më poshtë vijon:

NENI 1

Emri

Shoqëria tregtare me përgjegjësi të kufizuar mban emrin “**OMD - OFFICINA MECCANICA**” shpk.

Ndryshimi i emërimit të Shoqërisë mund të bëhet me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të Shoqërisë.

NENI 2

Forma

Shoqëria tregtare “**OMD - OFFICINA MECCANICA**” Shpk, ka formën e një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar.

NENI 3

Zyra Qëndrore

3.1 Shoqëria tregtare me përgjegjësi të kufizuar “**OMD - OFFICINA MECCANICA**” Shpk, do të ketë selinë e saj qëndrore në: DURRES, Shkozet , Lagjja14, Rruga Asti Nushi, Zona Kadastrale 8516, Njesi me Nr.pasurie5/628 .

3.2 Ndryshimi i selisë qëndrore të Shoqërisë mund të bëhet vetëm me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të Shoqërisë.



NENI 4

Objekti I veprimtarisë

Shoqëria ka si objekt aktiviteti tregtar:

Import – eksport , tregtimin, prodhimin dhe punime te ndryshme mekanike, sherbime ambalazhimi etj, brenda dhe jashte vendit. Aktivitet ne fushen e perpunimit te regjimit aktiv (fason). Tregeti me shumice e pakice te materialeve te para, ndihmese, produkte te ndermjetme e/o produkte te gatshme, import – eksport.

Shoqëria mund te kryeje çdo aktivitet tjeter te nevojshem apo te dobishem per realizimin e qellimeve te saj tregtare.

NENI 5

Kohëzgjatja

Shoqëria do të ushtrojë aktivitetin e saj për një periudhë deri me date 31.12.2050 dhe mund të shtyhet sipas ligjeve në fuqi.

NENI 6

Degët dhe Zyrat e Përfaqësimit

Shoqëria tregtare “**OMD - OFFICINA MECCANICA**” shpk mund të hapë degë të saj ose zyra përfaqësimi brenda ose jashtë vendit.

NENI 7

Përgjegjësia e Ortakëve

Ortakët nuk përgjigjen për detyrimet e shoqërisë “**OMD - OFFICINA MECCANICA**” shpk dhe mbulojnë personalisht humbjet e Shoqërisë deri në pjesën e pashlyer të kontributeve të nënshkuara prej tyre.

NENI 8

Kapitali i Regjistruar dhe Kuotat

8.1 Kapitali i regjistruar i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar “**OMD - OFFICINA MECCANICA**” shpk është **100.000 (njëqindmije) Leke**, ndarë në **2 kuota**, i cili është nënshkruar dhe derdhur rregullisht nga të gjithë ortakët.

8.2 Ortakët kanë kontribuar në krijimin e kapitalit të Shoqërisë dhe zotërojnë kuotat e tyre në këtë mënyrë:

- **Z. Filippo Varini** zotëron **1 kuota**, të barabartë me **50% të kapitalit** të Shoqërisë me vlerë **50.000 Lekë**.
- **Z. Erion Topciu** zotëron **1 kuota**, të barabartë me **50% të kapitalit** të shoqërisë me vlerë **50.000 Lekë**.

Erion Topciu

Filippo Varini

NENI 9
Organet e shoqërisë

9.1 Organet e Shoqërisë janë:

- Asambleja e ortakëve
- Administratori

Detyrat e organeve të Shoqërisë do të përcaktohen në statutin e Shoqërisë.

9.2 Në rast zmadhimi të kapitalit të regjistruar të Shoqërisë, të gjithë ortakët kanë të drejtë të nënshkruajnë dhe shlyejnë pjesët e kapitalit të zmadhuar në proporcion me pjesëmarrjen e tyre në kapital.

NENI 10

Administratori

10.1 Shoqëria administrohet nga një ose më shumë administratorë që emërohen dhe shkarkohet nga Asambleja e Përgjithshme. Afati i emërimit është 5 vjet, me të drejtë ripërtëritje.

Administratorët e Shoqërisë janë dhe kane kompetenca të pamvarura si me poshtë:

- **Z. Erion Topciu** është Administratori i përgjithshëm i Shoqërisë. Ai kryen veprimet e administrimit ligjor si dhe operacional, të zakonshëm dhe të jashtëzakonshëm.

NENI 11

Të gjitha mosmarrëveshjet midis ortakëve duhet të zgjidhen me mirëkuptim. Në rastet kur ato nuk mund të zgjidhen me mirëkuptim secili prej ortakëve ka të drejtë t'i drejtohet për zgjidhje gjykatës kompetente.

Ky Akt-Themelimi përpilohet në 4 (katër) origjinale në gjuhën shqipe.

ORTAKËT THEMELUES

Filippo Varini

Erion Topciu

DURRES 16 / 01 / 2023

3

Per ktheu :

Erion Topciu